



LAJMËRIM

“Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë - 2011”

TAKIM PUBLIK INFORMATIV

Të nderuar qytetarë,

Nga data 1 deri 15 prill 2011 do të filloje zyrtarisht procesi i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në gjithë territorin e Kosovës.

Qëllimi kryesor i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është: grumbullimi, përpunimi dhe publikimi i të dhënave dhe informacioneve të tjera për popullsinë, ekonomitë familjare dhe banesat sipas standardeve ndërkombëtare.

Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e regjistrimit është jetik dhe kusht për të qenë procesi i regjistrimit i suksesshëm dhe njëkohësisht për të përmbushur standardet e Kombeve të Bashkuara dhe të Bashkimit Evropian.

Me qëllim të informimit tuaj rreth procesit të regjistrimit në përgjithësi dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në veçanti, ATRC, në partneritet dhe me përkrahje nga REKOS dhe Enti i Statistikave të Kosovës organizon takimin publik informativ me qytetarë.

Takimi publik informativ do të mbahet me datën 16 mars 2011, ditë e mërkur, duke filluar nga ora 11.00, në Shtëpinë e Kulturës “Imri Curri” në Hanit të Elezit.

Ardhja juaj na nderon!

Me respekt,

Unë jam këtu